



Rregullatorët e tregjeve në zhvillim të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) theksojnë nevojën për një zë më të fuqishëm në reformën rregullatore globale për të pasqyruar gjendjen e tregjeve në zhvillim.

Vijon në faqen 2



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2013

Vijon në faqen 3

ZHVILLIME TË TJERA

Takimi vjetor i Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve të NAIC (SHBA, 9 -10 maj 2013)

Vijon në faqen 4

Takimi i pestë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (Sarajevë, 14-15 maj 2013)

Vijon në faqen 5

Raporti i progresit të Shqipërisë në luftën kundër pastrimit të parave (Paris, 16-17 maj 2013)

Vijon në faqen 6

Takim mbi mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit në funksion të parimeve të IOSCO-s (Toronto, 22-23 maj 2013)

Vijon në faqen 6

Takim rajonal për mbikëqyrësit në sigurime të Evropës Lindore dhe Qendrore, Azisë Qendrore dhe Transkaukasisë, mbi edukimin dhe mbrojtjen konsumatore

(Chisinau, Moldavi 28-30 maj 2013)

Vijon në faqen 7

LAJMET NGA RAJONI

Letoni *Vijon në faqen 8*

Rumani *Vijon në faqen 8*

Rusi *Vijon në faqen 9*

Slovaki *Vijon në faqen 9*

Turqi *Vijon në faqen 10*

Rregullatorët e tregjeve në zhvillim të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) theksojnë nevojën për një zë më të fuqishëm në reformën rregulatore globale për të pasqyruar gjendjen e tregjeve në zhvillim.

Informacioni i plotë mbi këtë takim mund të gjendet në:
<http://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS281.pdf>

Rregullatorë nga vende të ndryshme për tregjet në zhvillim të letrave me vlerë u takuan në Panama në 21-23 maj 2013. Në këtë takim, ata përforcuan nevojën për të luajtur një rol më aktiv në përpjekjet për reformën rregulatore globale. Përfshirja e tyre synohet të jetë që në fazat e hershme të këtyre reformave të reja për të siguruar që problematikat e tregjeve në zhvillim të jenë pasqyruar në procesin e reformës.

Në mbledhje gjithashtu u ra dakord për një përcaktimin të ri të rolit të ardhshëm të Komitetit të Tregjeve në Zhvillim (EMC) të IOSCO-s dhe riemërtimin e tij si Komiteti i Tregjeve në Rritje dhe Zhvillim (GEM), e cila pasqyron më mirë natyrën e tregjeve që veprojnë brenda tij. Anëtarë të këtij komiteti janë edhe disa nga ekonomitë me rritjen më të shpejtë në botë dhe 10 anëtarë janë nga vendet e G-20-ës.

Komiteti GEM do të kërkojë fokus më të madh drejt balancimit të rritjes me zbatimin e rregullave, duke kërkuar një gjithëpërfshirje më të madhe, forcimin e kanaleve të komunikimit dhe zhvillimin më të madh të kapaciteteve rregulatore për tregjet në zhvillim.

Anëtarësia mbështeti fuqishëm nevojën e krijimit të Fondacionit të IOSCO-s, i cili do të ndihmojë anëtarët në zhvillimin të tregut e tyre dhe në përpjekjet për rritjen e kapaciteteve. Anëtarët nxitën industrinë për të mbështetur krijimin e Fondacionit kështu që tregjet në zhvillim të përfitojnë nga aktivitetet e përgjithshme lidhur me tri shtyllat:

- Kërkimin;
- Edukimin dhe trajnimin;
- Asistencën teknike.

Financimi i rritur i këtyre aktiviteteve do të çojë në një përfitim të konsiderueshëm të anëtarëve, veçanërisht bazuar në kërkesat në rritje për financimin e tregut bazë.

EMC zhvilloi zgjedhjet për kryetarin e ri të saj. Kryetari i ri i EMC, Z. Ranjit Ajit Singh, theksoi se ekziston një mundësi e madhe për tregjet në zhvillim për të kontribuar në diskutime globale dhe që vetë komiteti të jetë një grupim shumë i dukshëm, efektiv dhe gjithëpërfshirës. "Duke vepruar kështu, tregjet në zhvillim duhet të kenë një zë më të fuqishëm dhe më gjithëpërfshirës dhe do të mbështeten nga një proces dhe strukturë efikase. Kontributi për debatin global rregullator duhet të përmirësohet. Zhvillimi i tregut dhe

Komiteti GEM do të kërkojë fokus më të madh drejt balancimit të rritjes me zbatimin e rregullave, duke kërkuar një gjithëpërfshirje më të madhe, forcimin e kanaleve të komunikimit dhe zhvillimin më të madh të kapaciteteve rregulatore për tregjet në zhvillim.

përprojekjet për ndërtimin e kapaciteteve mbeten thelbësore për shumë tregje në zhvillim dhe ne dëshirojmë krijimin e Fondacionit të IOSCO-s“ - shtoi Z. Ranjit Ajit Singh.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Greg Medcraft, i pranishëm në këtë mbledhje, theksoi nevojën e mbështetjes nga industria për të krijuar sa më parë Fondacionin IOSCO. Ai shprehu rëndësinë e madhe që kanë tregjet në zhvillim dhe gatishmërinë e tij për bashkëpunim.

Duke nënvizuar se anëtarët EMC përfaqësojnë 75% të anëtarësisë së IOSCO-s, Z. David Wright, sekretar i përgjithshëm i IOSCO-s, vlerësoi përvojën, dinamizmin dhe vizionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të sapozgjedhur të EMC-së.

Në përfundim u theksua nevoja për një riorganizimin më të mirë të drejtimit dhe mbikëqyrjes së tregut, si edhe për të siguruar një mënyrë të fortë dhe bashkëpunuese komunikimi në një nivele më të lartë. Në panele të veçanta u diskutua edhe për ndikimin e tregjeve elektronike tepër të sofistikuar (*High Frequency Trading and Algorithmic Trading, HFT*) në tregjet në zhvillim.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2013

Tregu i sigurimeve u rrit me 3.87% në janar-prill 2013. Vlera e primit të shkruar bruto në katër muajt e parë të vitit arriti në 2.78 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një rritje me 3.38% dhe arriti vlerën e 308,449 policave.

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 2.38% në janar-prill 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu dhe sigurimi i Jetës u rrit me 12.55%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje me 21.03% në krahasim me janar-prill 2012.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Sigurimi i detyrueshëm për periudhën janar-prill 2013 përbën 50.11% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të ketë arritur vlerën 1.22 miliardë lekë, me një rritje prej 4.48% nga janar-prill 2012.


Jo-Jeta, të tjera

Klasa të tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës përbëhen nga zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 22.71% të tregut të Jo-

Rritja më e madhe u vërejt në produktet e sigurimit të Jo-Jetës volumi i të cilave u rrit me 12.29% në periudhën janar-mars 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

Jetës, si dhe klasat sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 15.83% të tregut të Jo-Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-prill 2013



ZHVILLIME TË TJERA

Takim vjetor i Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve të NAIC

Në datat 9 dhe 10 maj 2013, në Washington, DC, SHBA , u zhvillua takimi vjetor i Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve, (*National Association of Insurance Commissioners, NAIC*) 2013.

Në takim u diskutua mbi: komponentët e mbikëqyrjes efektive të grupeve, rolin e sigurimeve si një mjet i menaxhimit të riskut të katastrofës, vendosjen e regjimeve efektive dhe rolin e strukturave për mbrojtjen e policëmbajtësve, perspektivat e drejtuesve mbi zhvillimet ndërkombëtare, rolin e OECD-së pas krizës financiare brenda G20 dhe reformat në drejtim të Mbikëqyrjes dhe Rregullimit Financiar, adresimin e stabilitetit financiar në sektorin e sigurimeve, etj.

Meqenëse industria e sigurimeve vazhdon të shtrihet edhe jashtë kufijve shtetërorë, përgjegjësia kryesore për të siguruar një mbikëqyrje efektive dhe stabilitet të tregjeve financiare i takon rregullatorëve kudo në botë. Rritja e mbikëqyrjes së këtij tregu lidhet edhe me efektet e krizës financiare dhe ekonomike botërore në sektorin e sigurimeve. Ky forum u fokusua në angazhimet e mëdha të rregullatorëve të sigurimeve të shteteve të Amerikës duke bashkëpunuar njëkohësisht edhe me institucionet homologe nëpër botë. Këto institucione po punojnë së bashku për të pranuar praktikat më të mira të mbikëqyrjes së sigurimeve në nivel ndërkombëtar, duke drejtuar kolegjet e mbikëqyrjes dhe duke asistuar në tregjet e sigurimeve të vendeve në zhvillim.

Rritja e mbikëqyrjes së këtij tregu lidhet edhe me efektet e krizës financiare dhe ekonomike botërore në sektorin e sigurimeve.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të lartë të autoriteteve rregullatore të fushës së sigurimeve nga shtete të ndryshme të SHBA-së dhe vendeve të tjera të botës.

Takimi i pestë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Në periudhën 14-15 maj 2013 në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë u zhvillua takimi rajonal mes mbikëqyrësve të sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE). Takimi u organizua nga Autoriteti Hungarez i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës. Ky ishte takimi i pestë në kuadër të iniciativës CESEE ISI, për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve të sigurimeve nga këto vende. Kjo iniciativë është prezantuar fillimisht në prill të vitit 2011 me synim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e një forumi diskutimi me fokus në problematikat aktuale të vendeve të rajonit.

Katër ishin prezantimet kryesore lidhur me mbikëqyrjen e risigurimeve, ndarjen e veprimtarisë së biznesit të sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në kompanitë kompozite, rolin e ndërmjetësve dhe përvojat lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të autoriteteve mbikëqyrëse.

Lidhur me mbikëqyrjen e risigurimit, prezantimi nga Autoriteti Austriak i Tregjeve Financiare u fokusua në kriteret ligjore të licencimit të shoqërive të risigurimit, kërkesat e përgjithshme dhe specifike të nevojshme përpara se të përmbillet një kontratë risigurimi, vlerën që kanë klasifikimet e agjencive ndërkombëtare për shoqëritë e risigurimit, etj.

Prezantimi nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë detajoi aspektet e ndryshme të veprimtarisë në sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës, eksperiencën e vendeve të ndryshme me Solvency I e II, si edhe problematikat e lidhura me Solvency II.

Përfaqësuesit e Agjencisë së Sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës shpjeguan legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime në vendin e tyre, duke dhënë edhe të dhëna statistikore për numrin dhe aktivitetin e ndërmjetësve në sigurimet dhe legjislacioni që rregullon komisionet e tyre.

Një sesion i veçantë ju dedikua zbatueshmërisë së vendimeve të autoriteteve mbikëqyrëse, sfidat me të cilat përballen këto autoritete, afatet kohore të zbatimit të vendimeve, si dhe mekanizmat e zbatimit kur vendimi i përket shoqërive që veprojnë në dy vende të ndryshme. Këtu u dha edhe këndvështrimi dhe përvoja e përfaqësuesve të Autoritetit Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare.

Me ndryshimet e fundit të bëra në strukturën organizative të IOSCO-s u vu në pah roli i rëndësishëm që ka SROCC dhe u vendos një përfshirje më e madhe e tij në vendimmarrje.

Në këtë takim, morën pjesë autoritetet homologe të vendeve si Austria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia.

Raporti i progresit të Shqipërisë në luftën kundër pastrimit të parave

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), në kuadër të mbikëqyrjes së Shqipërisë nga Financial Action Task Force (FATF) të Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës zhvilloi në periudhën 16-17 maj në Paris, Francë, takimin e radhës së Grupit Shqyrtues Rajonal të Evropës dhe Evroazisë (EERG), mbi masat e marra në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit.

Gjatë zhvillimit të takimit u shqyrtua raporti i progresit të Shqipërisë në drejtim të plotësimit të planit të veprimit. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, AMF, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesëmarrës në grupin teknik ndërinstytucional, për zbatimin e Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”.

Në takimin e Parisit u prezantuan hapat e ndërmarrë nga autoritetet shqiptare në fushën e parandalimit e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. Raporti përfundimtar për Shqipërinë, si dhe hapat e mëtejshëm për plotësimin e standardeve ndërkombëtare do të bëhen publike në takimin që do të mbahet në Oslo në datat 17-22 qershor.

Në takimin e Parisit u prezantuan hapat e ndërmarrë nga autoritetet shqiptare në fushën e parandalimit e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit.

Takim mbi mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit në funksion të parimeve të IOSCO-s

Komiteti Këshillimor i Organizatave vetë-rregullatore *Self Regulatory Organisations Consultative Committee* (SROCC) në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilluan në 22-23 maj 2013 takimin e 6-të mbi zbatimin e parimeve të IOSCO-s, në Toronto, Kanada.



Objektivi kryesor i SROCC është të ndajë eksperiencën midis anëtarëve të organizatave vetërregullatore dhe të kontribuojë në zbatimin e standardeve dhe parimeve bazë të IOSCO-s. SROCC ka dhënë kontributin e tij në përmirësimin e strukturës rregullatore, duke monitoruar tregjet dhe nxitur

zbatimin e rregullave, kërkesave dhe mbikëqyrjen me bazë risku. Me ndryshimet e fundit të bëra në strukturën organizative të IOSCO-s u vu në pah roli i rëndësishëm që ka SROCC dhe u vendos një përfshirje më e madhe e tij në vendimmarrje.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte zbatimi i parimeve bazë të IOSCO-s në lidhje me mbikëqyrjen e firmave, inspektimin dhe zbatimin e ligjit. U bënë prezantime, me raste të shumta studimi dhe sesione diskutimi mbi "Zbatimin e Parimeve të IOSCO-s". Të ftuarit që referuan, si dhe anëtarët e paneleve të ndryshme ishin përfaqësues të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare nga shume vende dhe rajone.

Takim rajonal për mbikëqyrësit në sigurime të Evropës Lindore dhe Qendrore, Azisë Qendrore dhe Transkaukazisë, mbi edukimin dhe mbrojtjen konsumatore

Në datat 28-30 maj 2013, në Chisinau, Moldavi u zhvillua takimi rajonal për mbikëqyrësit në sigurime të Evropës Lindore dhe Qendrore, Azisë Qendrore dhe Transkaukazisë, mbi edukimin dhe mbrojtjen konsumatore. Takimi u organizua nga Instituti për Stabilitetin Financiar, Financial Stability Institute (FSI), Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve, International Authority of Insurance Supervision (IAIS) dhe Komisioni për Tregjet Financiare të Republikës së Moldavisë.

Në takim u diskutua mbi:

- Principet kryesore dhe standardet evropiane në fushën e mbrojtjes konsumatore;
- Drejtimin e biznesit të sigurimeve dhe mbrojtjen konsumatore nëpërmjet zhvillimit dhe marketingut të produkteve, trajtimit të drejtë të konsumatorëve dhe trajtimit të dëmeve;
- Standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet e direktivave Evropiane mbi ndërmjetësit, si dhe roli i tyre në promovimin e besimit të publikut dhe kujdesit financiar;
- Politikat e mbikëqyrjes në drejtimin e biznesit të sigurimeve dhe promovimi i kujdesit financiar nëpërmjet informimit konsumator dhe mbrojtjes së interesit të policëmbajtësve;
- Mekanizmat e trajtimit dhe zgjidhjes së dëmeve duke filluar nga ndërmjetësimi, organizatat e pavarura për zgjidhjen e konflikteve, avokati i popullit dhe mekanizma të tjerë të trajtimit të dëmeve jashtë gjyqit, si dhe trajtimi gjyqësor i tyre;
- Sfidat rajonale mbikëqyrëse dhe rregullatore në fushën e drejtimit të biznesit dhe mbrojtjes konsumatore;
- Kontrollimi i hyrjes në tregun e sigurimeve nëpërmjet përcaktimit të kriterëve të licencimit, fokusimit në përshtatshmërinë e personave.

Katër ishin prezantimet kryesore lidhur me mbikëqyrjen e risigurimeve, ndarjen e veprimtarisë së biznesit të sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në kompanitë kompozite, rolin e ndërmjetësve dhe përvojat lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të autoriteteve mbikëqyrëse.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të Autoriteteve Mbikëqyrëse në fushën e sigurimeve të vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore, Azisë Qendrore dhe Transkaukasisë, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë, Polonisë, Rumanisë, Shqipërisë, Moldavisë dhe Republikës së Kazakistanit. Në përfundim të takimit temat e trajtuara u realizuan në zhvillimin e një rasti studimor mbi licencimin e një shoqërie sigurimi.

LAJMET NGA RAJONI

Letoni

Siguruesit letonezë kanë marrë disa aplikime për kompensim pas dëmtimeve të shkaktuara nga dukuritë natyrore. Ndër shembujt që përmend shtypi renditet kompania e sigurimeve “Balta”, e cila do të duhet të paguajë rreth 286,000 Euro apo “Ergo” rreth 57,000 Euro.



Kompensimi më i lartë e dhënë deri tani është paguar në vitin 2010 për një shtëpi private në Jelgava, ku kostoja totale e dëmit arriti në 57,000 Euro.

Kreu i departamentit të dëmeve në sigurimin e pronës Z. Ivo Danche shpjegon se ekspertët pranë “Balta” kanë vlerësuar tashmë 90% të të gjithë pasurisë së dëmtuar dhe kanë paguar tashmë 17.000 Euro në kompensim. Kompensimi është mohuar vetëm në nëntë raste, në të cilat për dëme të ngjashme tashmë ishin bërë pagesa në pesë vitet e fundit.

Sipas ekspertëve të “Balta”, të cilët kanë vlerësuar përmbytjet e këtij viti, rezulton se pagesa më e madhe e këtij viti do të shkojë për viktimat e përmbytjeve në Ogre. Aktualisht është dhënë 12,000 Euro në kompensim të dëmit nga përmbytjet por ekspertët besojnë se kostoja totale e dëmit mund të arrijë 71,000 Euro. Kompensimi më i lartë e dhënë deri tani është paguar në vitin 2010 për një shtëpi private në Jelgava, ku kostoja totale e dëmit arriti në 57,000 Euro.

Rumani

Në kuadër të “Ditës së brokerimit “ (*“Brokers’ Day”* at FIAR 2013) në FIAR 2013, Menaxheri i Përgjithshëm i MARSH, Rumani, z. Kristian Fugaciu deklaroi se tregu i brokerimit është rritur kohët e fundit në Rumani por kjo rritje duhet të jetë e qëndrueshme. Nga shifrat e prezantuara në këtë ditë rezulton se, në Rumani, në shpenzimet për sigurime të bëra nga një rumun më të ardhura mesatare, ato kanë rënë nën 100 Euro.



Në po këtë aktivitetet, gjatë ditës së Sigurimeve Motorike (*“Motor Insurance Day”* në FIAR 2013, Artur Borowski, nënkryetar i OMNIASIG VIG deklaroi se “Për sa kohë segmenti i MTPL-së është i shqetësuar, problemi kryesor në treg është çmimi i paqëndrueshëm i policave që rezultojnë nga

konkurrenca e ashpër, aq sa disa kompani të sigurimit nënshkruajnë vetëm për cash-flow. Lidhur me sigurimin Kasko, problemi kryesor konsiston në frekuencën ekstremist të lartë (mbi 50%) të dëmeve dhe si rezultat, siguruesit rumunë kanë çmimet më të larta në Evropën Qendrore dhe Lindore”.



Sipas të dhënave të prezantuara nga përfaqësuesi i VIG, ndërmjet viteve 2008 dhe 2012, marrja në sigurim e MTPL-së u zvogëlua me rreth 500 milionë euro, ndërsa vlera e dëmeve të paguara u rrit me më shumë se 25% pikë. “Situata është e vështirë në këtë segment. Konkurrenca është e ashpër për sa kohë çmimet janë shqetësuese dhe kjo është arsyeja pse tregu ka mbetur në të njëjtin nivel për 5 vitet e fundit”, deklaroi përfaqësuesi i VIG.

Rusi

Ministria Ruse e Kulturës po planifikon prezantimin e sigurimit të detyrueshëm të monumenteve arkitekturore në vend. I cituar nga agjencitë e lajmeve, Zëvendësministri i Kulturës Gregory Pirumov është shprehur se: “Në mënyrë që të ruajmë integritetin e monumenteve që kemi, ne duhet të dalim me nisma legjislative për ndryshimin e legjislacionit duke e vënë theksin në legjislacionin e sigurimeve”.



Sipas zëvendësministrit Pirumov, ky koncept i sigurimit do të përpunohet dhe më pas, gjatë vitit 2014, do të paraqitet për diskutim dhe për përshtatje legjislative.

Sllovaki

Më shumë se 183,000 automjete nuk janë të mbuluara me siguracion, i cili është sigurim i detyrueshëm. Byroja Sllovake e Sigurimit regjistroi në fund të vitit 2012 një total në numër prej 2,355,000 automjete të siguruar, megjithatë numri i përgjithshëm i automjeteve në Sllovaki, bazuar në statistikat e Ministrisë së Brendshme është 2,538,000. Agjencitë e lajmeve raportojnë se numri i automjeteve të pasiguruara përbënin afro 7.2% të të gjitha automjeteve të regjistruara. Në vitin e kaluar ishin rreth 171,000 automjete të pasiguruara.

Fitimet e kompanive të sigurimit që operojnë në Sllovaki arritën në 155 milion Euro në vitin 2012, duke shënuar kështu një rënie prej 20% më pak në krahasim me vitin e kaluar. Banka Kombëtare e Sllovakisë ia atribuon këtë rënie të fitimeve, fitimeve të larta që siguruesit realizuan gjatë vitit 2011.

Agjencitë e lajmeve raportojnë se numri i automjeteve të pasiguruara përbënin afro 7.2% të të gjitha automjeteve të regjistruara.

Turqi

Për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut të tërmetit, Turqia ishte ndër vendet e para në botë, në të cilën u vendos një sigurim i përbashkët (*insurance pool*) kundër këtij rreziku.



“Insurance pool” është një grupim i përbashkët i asetëve nga disa shoqëri sigurimesh. Grupimi përdoret si një mënyrë për të mundësuar mbulimin e rreziqeve shumë të larta. Të vetme, kompanitë nuk mund ta përballojnë riskun e marrjes së rreziqeve kaq të larta (siç është rasti i tërmeteve), por së bashku, duke grumbulluar asetet e tyre, ato mund ta përballojnë dhe madje të krijojnë një mbulueshmëri më të lartë.

Megjithatë, për shkak të dëmeve në shifra relativisht të larta dhe rezultatet teknike mjaft të dobëta të regjistruara nga kompanitë vendase, risigurimi për rrezikun ndaj tërmetit po përballet me vështirësi.

“Të ardhurat nga viti 2012 në linjën e rreziqeve natyrore ishin të vështira për shkak të ngjarjeve të mëdha në Azi dhe krizën ekonomike globale. Megjithatë, në vitin 2013 ato janë paraqitur në mënyrë të njëtrajtshme për shkak të përjashtimit që u bë vitin e kaluar për katastrofat e mëdha”, deklaroi Menekshe Ucaroglu, Menaxhere e Përgjithshme në Qendrën e marrjes në sigurim Stamboll.

Sipas saj tregu turk është ende i varur nga njëra anë nga marrëveshjet proporcionale mbi rreziqet natyrore dhe nga ana tjetër nga rezultatet teknike të dobëta të kompanive vendase, të cilat po e bëjnë gjithnjë e më të vështirë mbulimin me risigurim. Prandaj, tregu lokal u bë gjithnjë e më shumë i varur nga agjentët e risigurimit.

Për këtë numër punuan:

*R. Guri, D. Kalaja, V. Theodhori, I. Malile, L. Rama, A. Dervishi,
R. Eltari, F. Hebovija, J. Kurti, Dh. Hazbiu, E. Beqir-Aga, E. Kokona*